

VENDIM
Nr.47, datë 3.2.1997

**PËR MËNYRËN DHE KRITERET E SHPËRNDARJES SË PASURISË SË
FONDACIONEVE QË E KANË USHTRUAR VEPRIMTARINË E TYRE TË HUAMARRJES
MBI BAZËN E SKEMAVE PIRAMIDALE MASHTRUESE**

(Ndryshuar me vendimin nr. 522, datë 8.7.2005)

(I përditësuar)

Në bazë të ligjit nr.8190, datë 30.1.1997 "Për shpërndarjen e pasurisë së fondacioneve që e kanë ushtruar veprimtarinë e tyre të huamarrjes mbi bazën e skemave piramidale mashtruese", Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërndarja e pasurisë së fondacioneve, të cilat e kanë ushtruar veprimtarinë e tyre të huamarrjes mbi bazën e skemave piramidale mashtruese, do të fillojë në datën 5 shkurt 1997.

2. Të gjitha mjetet monetare që u janë ngurtësuar fondacioneve, do të depozitohen në llogari pranë bankave, të cilat do të bëjnë shpërndarjen e tyre. Llogaritë e bllokuara do të jenë në bankë në emër të fondacionit. Përdorimi i shumave të këtyre llogarive do të bëhet për shpërndarjen e pasurisë së fondacioneve huadhënësve në përputhje me kriteret e këtij vendimi.

3. Banka Kombëtare Tregtare do të bëjë shpërndarjen e pasurisë së fondacionit "Demokracia Popullore Xhaferri", kurse *Banka Kombëtare Tregtare* do të bëjë shpërndarjen e pasurisë së fondacionit "Populli".

Atje ku Banka Kombëtare Tregtare nuk ka degë të saja, shpërndarja e pasurisë bëhet në marrëveshje me *Banken Kombëtare Tregtare*.

4. Shpërndarja e pasurisë së fondacioneve do të kryhet në dy faza si vijon:

a) Faza e parë fillon më 5 shkurt 1997 dhe do të shpërndahen mjetet monetare të ngurtësuar në bankat e nivelit të dytë të këtyre fondacioneve në përqindje të njëjtë për të gjithë huadhënësit sipas fondacioneve, në përputhje me koeficientin e miratuar nga Komisioni i Posaçëm i krijuar në bazë të nenit 7 të ligjit nr.8190, datë 30.1.1997 "Për shpërndarjen e pasurisë së fondacioneve që e kanë ushtruar veprimtarinë e tyre të huamarrjes mbi bazën e skemave piramidale mashtruese".

b) Faza e dytë do të fillojë në përfundimin e shitjes së të gjitha pasurive të tjera, të parashikuara në nenin 2 të ligjit nr.8190, datë 30.1.1997 "Për shpërndarjen e pasurisë së fondacioneve që e kanë ushtruar veprimtarinë e tyre të huamarrjes mbi bazën e skemave piramidale mashtruese". Në masën e detyrimit që do të shpërndahet në këtë fazë, përfshihen edhe mjetet monetare që mund të vijnë si pasojë e konfiskimeve. Të ardhurat që grumbullohen sipas kësaj pike, u shpërndahen huadhënësve në përputhje me pjesën që u takon sipas kuotës së huadhënies personale.

5. Në kuptim të nenit 5 të ligjit nr.8190, datë 30.1.1997 "Për shpërndarjen e pasurisë së fondacioneve që e kanë ushtruar veprimtarinë e tyre të huamarrjes mbi bazën e skemave piramidale mashtruese", si huadhënës përfitues të fondacioneve do të konsiderohen të gjithë ata persona që rezultojnë si të tillë në bazë të dokumentacionit të fondacioneve dhe që i kanë depozituar shumat e tyre pranë fondacioneve.

6. Bankat e parashikuara në pikën 3 të këtij vendimi do t'u llogaritin huadhënësve në librezën e kursimit interesat bankare që nga data e ngurtësimit të fondeve të këtyre fondacioneve.

Shpërndarja e shumave huadhënësve do të bëhet në të holla ose me librezë kursimi. Sasia e parave që do të jepet në të holla, do të jetë në përputhje me rregullat dhe rekomandimet e Bankës së Shqipërisë për këtë qëllim.

7. Shpërndarja e pasurisë huadhënësve të fondacioneve do të bëhet pranë sporteleve të bankave të parashikuara në pikën 3 të këtij vendimi. Sportelet do të konsiderohen si objekte

të rëndësisë së veçantë dhe do të ruhen nga forcat e policisë së rendit.

Ministria e Brendshme merr masat për ruajtjen e sporteleve sipas kërkesave që do t'i bëjnë bankat e parashikuara në pikën 3 të këtij vendimi.

8. Radha e shpërndarjes së shumave ose librezave të kursimit huadhënësve do të jetë sipas afateve të tërheqjes së parave nga fondacionet, në përputhje me dokumentet që disponon secili fondacion. Si datë e parë e dhënies së shumave ose librezave të kursimit huadhënësve të fondacioneve do të jetë data më e hershme, kur fondacioni nuk ka kryer pagesat huadhënësve. Datat e tjera pasardhëse shtyhen në përputhje kronologjike me këtë datë.

Bankat do të publikojnë në mjetet e informimit publik vendet e sporteleve, datat e tërheqjes së shumave, orarin e kryerjes së veprimeve, si dhe numrin e personave që do të paraqiten në datën e caktuar pranë sporteleve të bankave sipas pikës 3 të këtij vendimi.

9. Huadhënësit do të paraqesin si dokumentacion për tërheqjen e parave mandatarkëtimin, i cili vërteton shumën e derdhur, emrin e personit që ka derdhur shumën, si dhe dokumentin identifikues të personit. Nuk lejohet tërheqja e shumave ose librezave të kursimit me prokurë.

Në rast se në mandatarkëtimin figuron emri i më shumë së një personi, të drejtën për marrjen e shumave ose tërheqjen e librezave të kursimit e ka personi që paraqet mandatarkëtimin.

10. Shpërndarja e shumave dhe e librezave të kursimit huadhënësve do të bëhet nga një grup personash i përbërë nga:

- a) punonjësit e bankës, në përputhje me pikën 3 të këtij vendimi;
- b) personi që ka kryer ekspertimin kontabël të dokumentacionit të fondacionit.

11. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe të gjitha organet ose institucionet që mbajnë regjistra për pasuri të ndryshme, duhet të paraqesin në Ministrinë e Privatizimeve dokumentacionin për identifikimin e këtyre pasurive.

12. Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë të nxjerrin udhëzime të veçanta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi